

## Shtojca 13

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

**17 Gusht 2018**

**Për: Irakli Dinaj (STUDIO PRIVATE PROJEKTIMESH STUDIMESH**

**MONITORIMESH ARBI SHPK), NIPT:K62022009S Adresa:** Njesia Bashkiake Nr. 4, Rruga e Dibres, Kompleksi Orion Nr. 2, Kulla C, Kati i trete, Ap. 101

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-79289-07-14-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mbikqyerje të Rindërtim i shkollës 9- vjeçare, fshati Letaj, Has”.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): [Buletini](#) i Njoftimeve Publike -*Njoftim Kontrate Nr.29, date 23.07.2018*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. “ELDA-VL” SHPK VLORE L. H. CAKERRI 88, NIPT: K67106202W**

Vlera *0.0(zero) leke (Paraqitur Oferte pa vendosur vlere)*

**2. Irakli Dinaj (STUDIO PRIVATE PROJEKTIMESH STUDIMESH MONITORIMESH ARBI SHPK), Adresa:** Njesia Bashkiake Nr. 4, Rruga e Dibres, Kompleksi Orion Nr. 2, Kulla C, Kati i trete, Ap. 101 **NIPT:K62022009S**

**Vlera 400,000.0 (katërqindmijë) lekë pa tvsh**

**3. “NOVATECH STUDIO” SHPK, NIPT: L01717030C,** Adresa: Njesia bashkiake nr 8, rruga Shenasi Dishnica, nr pasurie 10/221+1-18, zona kadastrale 8370, hyrja 1, ap 18 , Tirane,

**Vlera: 420,191 (katerqind e njezete mije e njeqind e netedhjetë e nje) lekë pa tvsh**

**4. “REAN 95” SHPK, NIPT: J61827043V,** Adresa: Rruga Musa Karapici,banesa numër 6, TIRANE

**Vlera: 387,889.0 (Treqind e tetëdhjetë e shtatëmijë e tetëqind e tetëdhjetë e bëbtë) lekë pa Tvsh**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**1. “ELDA-VL” SHPK, NIPT: K67106202W**

*Nuk ka paraqitur asnje document kualifikues sipas shtojces 7 (Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes)*

Vlera 0.0(zero) leke (Paraqitur Oferte pa vendosur vlere)

## 2. “REAN 95” SHPK, NIPT: J61827043V

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Shoqeria “REAN 95” sh.p.k. ka paraqitur kontraten individuale te punes me Nr. 998 Rep. Nr. 517 Kol. date 12.05.2017 me punemarresin Z. Naim Baci, me detyre Ing. Ndertimi. Palet kane pranuar me marreveshje pagen mujore prej 23,000 Leke. Ne VKM Nr. 399 date 3.5.2017 “Per percaktimin e Pages Minimale ne shkalle vendi” percaktohet: “1. Paga baze minimale mujore, per punonjesit, ne shkalle vendi, qe eshte e detyrueshme te zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas e i huaj, te jete 24.000 (njezet e kater mije) leke.”

- Ne Dokumentat Standarte te Tenderit, eshte percaktuar se:

Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë:

a. Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar shërbime mbikqyrje ndertim qe do kryhen ne objektin që prokurohet, me vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Si dëshmi të paraqitet vërtetim i lëshuar nga një ent publik, kontrata e nënshkruar për shërbimin, si dhe akt kolaudime te perfundimit te punimeve.

Per realizimin me sukses te shërbime te ngjashem me objektin që prokurohet (ndertim) konform kushteve teknike dhe legjislacionit respektiv ne fuqi gjate 3-viteve te fundit eshte e nevojshme qe operatori ekonomik te vertetoje me kontrata dhe akt kolaudime te perfundimit te punimeve se ka kryer me sukses kontrata të natyres se ngjashme ne vlere sa 50% e fondit limit.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi të paraqiten kontrata e nënshkruar dhe akt kolaudime te perfundimit te punimeve. Operatori ekonomik qe ka perfunduar me sukses kontrata te ngjashme (ndertim) me operator privat duhet ti vertetoje ato, qe i ka kryer me sukses nga Investitori duke paraqitur kontrata dhe akt kolaudime te perfundimit te punimeve me vlere sa 50% e fondit limit, konform ligjeve ne fuqi.

- Operatori ekonomik shoqeria “REAN 95” sh.p.k., per kete procedure prokurimi ka paraqitur si “Pune te ngjashme” kontratat si vijon:

a.“Mbikqyrje punimesh per Rikonstruksionin e Kopeshtit dhe palestres ne shkollen Koli Sako, Bashkia Divjake”, me vlere 80,000 Leke – mungon akt kolaudimi i perfundimit te punimeve dhe vertetim te leshuar nga enti publik.

b.“Mbikqyrje e punimeve per objektin Ndertim i ri i ambjenteve te punes ne Drejtorine Rajonale te Formimit Profesional Publik nr. 4 Tirane”, me vlere 530,800 Leke, e lidhur ndermjet autoritetit kontraktor Sherbimi Kombetar i Punesimit dhe bashkimit te operateve ekonomike JV “REAN 95” sh.p.k. & “DRICONS” sh.p.k. - mungon akt kolaudimi i perfundimit te punimeve sidhe vertetim te leshuar nga enti publik. Sipas kontrates se bashkepunimit Nr. 2300 Rep. nr. 1161/1 Kol. date 10.11.2016 shoqeria “DRICONS” sh.p.k. me perfaqesues Z. Vladimir Topi, ka perfaqesimin ne kete kontrate me 30%, kurse shoqeria “REAN 95” sh.p.k. me perfaqesuese Z. Razije Naipi, ka 70%. Ne marreveshjen e bashkepunimit eshte percaktuar se: “Perfaqesimi i paleve, si te pranishem ne kete Kontrate Bashkepunimi, do kete te drejten per lidhjen e kontrates te bashkepunimit, ne emer dhe per llogari te Paleve si dhe perfaqesimin e tij perpara organeve Kompetente Administrative, qe kane lidhje me permbushjen e Objektit te Bashkepunimit.

Per kete objekt shoqeria “REAN 95” sh.p.k. ka paraqitur faturen tatimore te shitjes Nr. 33, date 30.06.2017, me vlere 530,800 Leke pa tvsh, e cila perfaqeson 100% vleren e kontrates. Kjo fature

është prere në kundërshtim me Kontraten e Bashkëpunimit duke rënë ndesh me Ligjin “Për Procedurat Tatimore në RSH” dhe ligjin “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar”.

c. “Mbikqyrje e punimeve për objektin Rikonstruksion i zyrës vendore të shërbimit kombëtar të punësimit Kavaje”, me vlerë 77,000 Leke – mungon akti i kolaudimit i përfundimit të punimeve dhe vërtetimi të lëshuar nga enti publik.

- Shoqëria “REAN 95” sh.p.k. në ekstraktin historik të shoqërisë, rezulton se në pikën 9 “Objekti i aktivitetit” ushtron aktivitetin e saj sipas licencës së shoqërisë Nr. 1506/6 datë 01.08.2016. Për këtë procedurë prokurimi ky operator ekonomik nuk ka dorëzuar këtë licencë.

Operatori ekonomik “REAN 95” sh.p.k. skualifikohet nga kjo procedurë prokurimi, pasi nuk ka arritur të plotësojë “Kërkesat për kualifikim”, të përcaktuara në shtojcën 7, pika 2 Kriteret e Vecanta të kualifikimit, kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike “Punë të ngjashme” dhe kapaciteti teknik dhe profesional, 1 Ing. Ndertimi.

### 3. “NOVATECH STUDIO” SHPK, NIPT: L01717030C

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- **Në Dokumentat Standarte të Tenderit, është përcaktuar se:**

#### **Kapaciteti Ligjor i operatoreve ekonomike:**

a. Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar shërbime mbikqyrje ndërtim që do kryhen në objektin që prokurohet, me vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Si dëshmi të paraqitet vërtetimi i lëshuar nga një ent publik, kontrata e nënshkruar për shërbimin, si dhe akti i kolaudimit të përfundimit të punimeve.

*Per realizimin me sukses të shërbimeve të ngjashme me objektin që prokurohet (ndërtim) konform kushteve teknike dhe legjislativës respektiv në fuqi gjatë 3-viteve të fundit është e nevojshme që operatori ekonomik të vërtetojë me kontratë dhe akti i kolaudimit të përfundimit të punimeve se ka kryer me sukses kontratë të natyrës së ngjashme në vlerë sa 50% e fondit limit.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi të paraqiten kontrata e nënshkruar dhe akti i kolaudimit të përfundimit të punimeve. *Operatori ekonomik që ka përfunduar me sukses kontratë të ngjashme (ndërtim) me operator privat duhet të vërtetojë ato, që i ka kryer me sukses nga Investitori duke paraqitur kontratë dhe akti i kolaudimit të përfundimit të punimeve me vlerë sa 50% e fondit limit, konform ligjeve në fuqi.*

- Operatori ekonomik shoqëria “NOVATECH STUDIO” sh.p.k., për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur si “Punë të ngjashme” kontratat si vijon:

a- Kontrata me objekt “Mbikqyrje punimesh për objektin Ndertim palestres pranë shkollës “Sabah Sinani” dhe “Migjeni”, Bashkia e Pukës është paraqitur fotokopje. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

b- Kontrata me objekt Mbikqyrjen e punimeve për Rikonceptim i Zyrave të AKSHI-t (faza 2) ka vlerë 93,968 Leke, pra me pak sesa 50% e fondit limit të kontratës së prokuruar.

Operatori ekonomik “Novatech Studio” sh.p.k. skualifikohet nga kjo procedurë prokurimi, pasi nuk ka arritur të plotësojë “Kërkesat për kualifikim”, të përcaktuara në shtojcën 7, pika 2 Kriteret e Vecanta të kualifikimit, kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike “Punë të ngjashme”.

Operatori ekonomik duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje në thelb

me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Irakli Dinaj (STUDIO PRIVATE PROJEKTIMESH STUDIMESH MONITORIMESH ARBI SHPK)**, Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 4, Rruga e Dibres, Kompleksi Orion Nr. 2, Kulla C, Kati i trete, Ap. 101 **NIPT:K62022009S** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **400,000.0 (katërqindmijë) lekë pa tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkisë Has, Pallati i Kultures Krume – Has*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5(pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet **sigurimi i ofertës suaj (Jo, nuk eshte kerkuar)**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **10/08/2018**

Ankesa: **Nuk ka ankesa**  
**Adem LALA**

Drejtuesi i autoritetit kontraktor Bashkia Has

---